

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6806
E enjte, 19 janar 2023
çmimi 0.40 €

Parlamenti Evropian
kërkon parandalimin e
ndikimit të Rusisë në
Ballkan | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E RADHËS PËRGATITORE PËR GJYKIMIN
E LIDERËVE TË UÇK-së | FAQE 4-5

BETEJA E LIDERËVE TË UÇK-së ME SPECIALEN NIS NË MUAJIN MARS



Gjykimi në Hagë ndaj Hashim
Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
Selimit dhe Jakup Krasniqi pritet të
fillojë në mesin e muajit mars të
këtij viti. Gjykimi ishte paraparë të
fillonte më 1 mars, por në

konferencën përgatitore të mbajtur
të mërkurën palët kanë kërkuar që
gjykimi të shtyhet për së paku dy
javë. ZPS-ja ka thënë se do të
marrë 6 orë kohë për fjalën hyrëse,
ndërsa edhe avokatët e katër

liderëve të UÇK-së kanë thënë se
do ta paraqesin fjalën e tyre hyrëse
pas prokurorisë. Gjykatësi Charles
L. Smith III ka kërkuar nga ZPS-ja
që ta shqyrtojë mundësinë të ulet
numri i dëshmitarëve

Reagim i KMDLNj-së

**OLIVER IVANOVIQI KISHTË
PËRGJEGJËSI PËR EKZEKUTIMIN
E 49 SHOIPTARËVE GJATË DHE
PAS PËRFUNDIMIT TË LUFTËS
NË KOSOVË** | FAQE 3



**"I PIKËLLUAR ALBIN
KURTI", PSD-ja PARA
QEVERISË VENDOS
FOTOGRAFINË E
IVANOVIQIT ME
KURORA LULESH** | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



**MALISHEVA PARQET SOKOLIN,
SERMAXHAJ PËR LARGIM AKUZON
DREJTORIN KASTRIOT KAFEGJOLLI**

F. 12

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Parlamenti Evropian kërkon parandalimin e ndikimit të Ruisë në Ballkan

BRUKSEL, 18 JANAR - Në seancën plenare të Parlamentit Evropian në Strasburg është votuar Rezoluta për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Bashkimit Evropian. Kjo rezolutë fokus kryesor e ka forcimin e rolit të BE-së në botë dhe përgjigjen që duhet dhënë në rrethanat e reja ndërkombëtare pas agresionit të Ruisë ndaj Ukrainës.

Në tekstin e rezolutës, që ishte miratuar së pari në Komisionin e Politikës së Jashtme, u propozua që në disa fusha në politikën e jashtme, Bashkimi Evropian të votojë me shumicë të kualifikuar e jo me konsensus në mënyrë që votimi të jetë më efikas.

Në disa pjesë të Rezolutës përmendet edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor, prej ku kërkohet që BE-ja ta përshpejtojë procesin e zgjerimit si me vendet kandidatë, ashtu edhe me kandidatët potencialë, raporton REL.

Gjithashtu, përmes kësaj rezolute kërkohet që sa më parë të hiqen vizat për qytetarët e Kosovës si dhe përshëndetet nisja e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe dhënia e statusit të vendit

kandidat për Bosnjë-Hercegovinën.

Në disa pjesë të tekstit përmendet ndikimi negativ i Ruisë në rajonin e Ballkanit, me synim të destabilizimit të rajonit, dhe bëhet thirrje që të parandalohet ky ndikim.

Në mënyrë të veçantë në tekst i bëhet thirrje Serbisë, e cila është vend kandidat për anëtarësim në BE, që t'i respektojë vlerat evropiane dhe ta përshtatë politikën e saj të jashtme me atë të Bashkimit Evropian. Serbia vazhdon të jetë shteti i vetëm në rajon i cili nuk i ka mbështetur sanksionet ndaj Ruisë.

Po ashtu, thuhet se vazhdimi i negociatave të anëtarësimit me Serbinë do të bëhet vetëm pasi ky shtet të jetë në linjë të njëjtë me sanksionet e BE-së ndaj Ruisë.

“Parlamenti Evropian nënvizon se të gjitha vendet që duan të bashkohen me BE-në duhet në tërësi të përshtaten me vlerat themelore dhe politikën e përbashkëta lidhur me agresionin e paligjshëm të Ruisë ndaj Ukrainës”, thuhet në tekst.

Rezoluta bën thirrje edhe për masa ndaj atyre që rrezikojnë



unitetin dhe integritetin territorial të Bosnjës-Hercegovinës dhe kërkohen sanksione ndaj liderit të Republikës Sërpska në Banjallukë, Millorad Dodik. “Parlamenti Evropian përsërit thirrjen për miratimin e sanksioneve specifike kundër aktorëve destabilizues në Bosnjë-Hercegovinë, përfshirë edhe ata që rrezikojnë sovranitetin dhe integritetin

territorial, posaçërisht ndaj Millorad Dodikut”, thuhet në këtë tekst dhe bëhet thirrje që vendet anëtare sa më parë t'i miratojnë këto sanksione. Ndonëse nuk përmendet me emër në tekstin e rezolutës, nga Komisioni Evropian kërkohet që të nisë hetime të brendshme ndaj komisionarit për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, për shkak të raporteve se ai ka “ndërhyrë për ta anashkaluar

shkeljen e vlerave demokratike dhe sundimit të ligjit në disa vende candidate”. “Parlamenti Evropian mbetet thellësisht i shqetësuar për raportet se komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim, me qëllim bën përpjekje që të anashkalohet dhe ulet rëndësia qendrore e reformave demokratike dhe sundimi i ligjit në vendet që janë në proces të anëtarësimit”, thuhet në tekst.

Së paku 16 të vdekur, përfshirë edhe ministrin e Brendshëm të Ukrainës, nga rrëzimi i helikopterit



KIEV, 18 JANAR - Të paktën 16 persona kanë humbur jetën, përfshirë ministrin e Brendshëm të Ukrainës dhe dy fëmijë, pas përplasjes së një helikopteri pranë një kopshti të fëmijëve në periferi të Kievit të mërkurën.

Sipas Ihor Klymenko, shef i Policisë Kombëtare të Ukrainës, nëntë nga të vrarët ishin në bordin e helikopterit.

Ministri Denys Monastyrsky ishte një nga tetë personat në helikopter.

Zëvendësi i tij dhe sekretari i shtetit gjithashtu humbën jetën. Bëhet me dije se janë edhe 22 persona të plagosur, mes tyre 10 fëmijë.

Guvernatori rajonal i Kievit, Oleksiy Kuleba, tha se “në momentin e tragjedisë kanë qenë të pranishëm fëmijë dhe punonjës të kopshtit”.

Kuleba shtoi se ka njerëz të lënduar, por nuk dha hollësi të tjera.

Ekipet mjekësore, policia dhe zjarrfikësit, janë në vendin e

ngjarjes, shtoi ai.

Gjermania i ka ofruar ndihmë Kievit për hetimin e rrëzimit të helikopterit. Ministria e Brendshme gjermane, Nancy Faeser, tha përmes një deklaratë se i ka dërguar telegram ngushëllimi qeverisë ukrainase dhe i ka ofruar “mbështetjen e Gjermanisë për ta identifikuar shkakun e rrëzimit të avionit”. Ndërkaq kancelari gjerman Olaf Scholz tha se ky aksident tregoi “çmimin e lartë” që Ukraina po paguan “në këtë luftë”.

Hungaria kërkon të heqë 9 persona të afërt me Putinin nga lista e sanksioneve të BE-së

BUDAPEST, 18 JANAR - Hungaria po tenton edhe një herë t'i dobësojë sanksionet e Bashkimit Evropian kundër Ruisë, duke kërkuar heqjen e nëntë individëve nga lista e personave të sanksionuar, që u vendosën ndaj mbi 1 300 individëve dhe 170 subjekteve në përgjigje të agresionit ndaj Ukrainës nga Moska.

Sipas disa burimeve diplomatike, Hungaria po

kërkon në mënyrë specifike heqjen e Alisher Usmanov, Pyotr Aven dhe Viktor Rashnikov nga lista e ndalimit të vizave dhe ngrirjes së aseteve, raporton REL.

Gazeta zyrtare e BE-së e quan Usmanov një “oligark pro-Kremlinit me lidhje veçanërisht të ngushta me presidentin rus Vladimir Putin”. Ai është përmendur si një nga “oligarkët e preferuar të Putinit”.

BE thotë se Aven “është një nga 50 biznesmenët e pasur rusë që takohen rregullisht me Vladimir Putin në Kremlin” dhe se ai “nuk vepron në mënyrë të pavarur nga kërkesat e presidentit”.

Rashnikov, ndërkohë, iu shtua listës në mars, me Brukselin që e përshkruan atë si “një nga oligarkët kryesorë rusë”.

Kjo nuk është hera e parë që Hungaria tenton t'i heqë këta individë nga kjo listë.



Në Davos Lajçaku takon ndaras Kurtin e Vuçiqin



PRISHTINË, 18 JANAR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialog, Miroslav Lajçak, ka takuar të mërkurën ndaras kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Takimet me dy liderët, më 18 janar, Lajçaku i zhvilloi ndaras në Forumin Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës.

Lajçaku ka shkruar në rjetin social "Twitter" se gjatë takimit me Kurtin diskutuan "për hapat e ardhshëm në dialog për normalizimin e marrëdhënieve dhe çështjet aktuale".

Edhe në takimin e tij me Vuçiqin, u tha se u diskutua për situatën në rajon dhe dialogun ndërmjet

Beogradit dhe Prishtinës.

Lajçaku pritet që më 20 janar ta vizitojë Kosovën, më pas edhe Serbinë, për ta përgatitur terrenin për vazhdimin e dialogut në nivel të lartë në Bruksel. Ai do të jetë i shoqëruar nga emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, nga i dërguari i posaçëm i Francës, Emmanuel Bonne, dhe ai i Gjermanisë, Jens Plotner, njoftoi në një konferencë për medie të mërkurën, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Kosova është nën presion që ta nisë punën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që, sipas ShBA-së dhe BE-së, është obligim i Prishtinës.

Nderohet jeta dhe vepra e akademikes Edi Shukriu

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 JANAR - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka mbajtur të mërkurën mbledhje përkujtimore dhe homazhe me rastin e ndarjes nga jeta të akademikes Edi Shukriu.

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Mehmet Kraja, ka theksuar se nga sot do të jenë më të varfër jo vetëm për një arkeologe të shkëlqyer, historiane, profesore, shkrimtare, poete e dramaturge, por do të jenë më të varfër për një personalitet të veçantë që kishte mbresinë e observimit intelektual.

Sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, Gjyljeta Mushkolaj, në emër të Akademisë së Shkencave

dhe të Arteve të Kosovës, derisa kujtoi figurën e saj, e vlerësoi Shukriun si një person me vlera të mëdha që kishte për vendin.

Valtuda Shukriu, mbesa e Edi Shukriut, kujtoi disa nga fjalët dhe poezitë e arkeologes Shukriu, derisa tha se asnjëherë nuk është ndalur duke qenë këmbëngulëse për emancipim e barazi mes popujve e gjinive.

Varrimi i të ndjerës është bërë në varrezat katolike të qytetit të Prizrenit.

Edi Shukriu ndërroi jetë më 17 janar 2023. Ishte një emër i njohur dhe i çmuar në fushën e arkeologjisë, të historisë, të letërsisë, të angazhimeve politike, institucionale dhe kulturore në Kosovë dhe në mbarë hapësirën shqiptare.



Kurti takon zëvendëspresidenten e Zvicrës, flasin për më shumë bashkëpunim në ekonomi dhe mbrojtje



DAVOS, 18 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar zëvendëspresidenten e Zvicrës, Viola Amherd dhe ministrin e Ekonomisë, Guy Parmelin, në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror që po mbahet në Davos të Zvicrës.

Kryeministri Kurti ka shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e Zvicrës dhënë për Kosovën dhe për ndihmën e vazhdueshme në programet e zhvillimit të ekonomisë dhe demokracisë.

U theksua rëndësia e mërgatës sonë në Zvicër, që është urë

lidhëse mes dy shteteve tona dhe kontribuon në ekonominë e të dyja vendeve.

U bisedua për mundësitë për më shumë bashkëpunim në ekonomi dhe mbrojtje. Me theks të veçantë u bisedua edhe për shkëmbim të përvojave në teknologji të informacionit dhe edukim.

Kryeministri Kurti ka ritheksuar përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për reforma strukturore në ekonomi, politikë, sundim të ligjit dhe demokraci funksionale në përputhje me standardet evropiane.

Hoti kritikon Kurtin: Thirrjet për investitorë dhe paralajmërimet për konflikt nuk shkojnë bashkë

PRISHTINË, 18 JANAR - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka reaguar për takimet e kryeministrit Albin Kurti me liderët të fushës politike dhe ekonomike në Forumin Ekonomik në Davos. "Davos: Thirrje për investitorë dhe paralajmërimet për konflikt nuk shkojnë bashkë. Shkon në

Davos dhe e organizon një minikonferencë për investime, për të cilën e paguan një kompani konsulente 58,341.19 franga zvicerane pa asnjë procedurë prokurimi", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka theksuar se në dhomën tjetër kërkon një 70 trupa më shumë të KFOR-it nga

Finlanda, edhe pse KFOR-i e rrit dhe e zvogëlon numrin e ushtarëve brenda natës sipas nevojës që ka. "Çfarë mesazhe janë këto dhe çfarë promovimi i investimeve është ky?! Kush po e këshillon kështu?! Kah na shpie kjo qasje në fushën e politikës dhe të ekonomisë?!", ka shkruar Hoti.





ËSHTE MBAJTUR KONFERENCA E RADHËS PËRGATITORE PËR GJYKIMIN E LIDERËVE TË UÇK-SË

Beteja e liderëve të UÇK-së me Specialen nis në muajin mars

Gjykimi në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi pritet të fillojë në mesin e muajit mars të këtij viti. Gjykimi ishte paraparë të fillonte më 1 mars, por në konferencën përgatitore të mbajtur të mërkurën palët kanë kërkuar që gjykimi të shtyhet për së paku dy javë. ZPS-ja ka thënë se do të marrë 6 orë kohë për fjalën hyrëse, ndërsa edhe avokatët e katër liderëve të UÇK-së kanë thënë se do ta paraqesin fjalën e tyre hyrëse pas prokurorisë. Gjykatësi Charles L. Smith III ka kërkuar nga ZPS-ja që ta shqyrtojë mundësinë të ulet numri i dëshmitarëve

EPOKA ERE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 18 JANAR - Të mërkurën është mbajtur konferenca e radhës përgatitore për gjykimin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Në këtë konferencë përgatitore, liderët e UÇK-së kanë marrë pjesë fizikisht në sallën e konferencës.

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka bërë me dije se është e gatshme që gjykimi ndaj katër liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të fillojë në muajin mars të këtij viti.

ZPS-ja ka theksuar se është gati ta fillojë gjykimin pavarësisht prej

volumit të punës, procedurave dhe dokumenteve që duhet të shqyrtohen.

Gatishmërinë për fillim të gjykimin në muajin mars e kanë shprehur edhe avokatët mbrojtës të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, ish-kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe ish-shefit të deputetëve të Vetëvendosjes, Rexhep Selimi.

Avokati mbrojtës i Kadri Veselit, Ben Emerson, ka thënë se ekipi i tij është i gatshëm për fillim të gjykimin në muajin mars, megjithatë ai ka thënë se “kanë para vetes një periudhë jashtëzakonisht intensive pune” deri në fillimin e gjykimin.

Avokatët mbrojtës të liderëve të

UÇK-së dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë pajtuar të mos lexohet aktakuza në fjalën hyrëse në fillim të gjykimin. Pavarësisht kësaj, ZPS-ja ka thënë se do të mbajë një deklaratë hyrëse.

Edhe avokatët mbrojtës kanë thënë se do të bëjnë një deklaratë hyrëse pas deklaratës së ZPS-së në fillim të gjykimin.

Trupi gjykes i Speciales kërkon nga ZPS-ja ta ulë numrin e dëshmitarëve në rastin e liderëve të UÇK-së

Kryetari i trupit gjykes në Gjykatën Speciale, Charles L. Smith III, ka kërkuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) që ta ulë numrin e dëshmitarëve në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi. “Kërkojmë nga ZPS-ja që t’i shqyrtojë edhe një herë argumentet e saj për ta ulur numrin e dëshmitarëve që përsëriten dhe për t’i përzgjedhur vendet e krimeve, incidentet apo vendet e paraburgimit”, ka thënë Smith, duke shtuar se synojnë që

brenda 600 orëve brenda një viti të dëgjohen dëshmitarët e këtij procesi gjyqësor. “Ne kemi treguar vizionin tonë lidhur me ditët e seancave për periudhën në vazhdim, dhe nëse kjo funksionon siç duhet, do të dëgjohen dëshmi për 600 orë në një vit dhe mund të them se nga përvoja ime që asgjë nuk është perfekte dhe gjyqi mund që zgjasë më shumë sesa shpresojmë. Është angazhim mjaft i madh për të pasur 600 orë brenda një viti megjithëkëtë ky është synimi që kemi. Ne e kemi autoritetin sipas rregullës 118 për të marrë masa për ta ulur numrin e dëshmitarëve, të akuzave, të vendit të krimeve dhe për t’i kërkuar ZPS-së ta zvogëlojë periudhën e pyetjeve paraprake që u bën dëshmitarëve. Ne do t’i shfrytëzojmë të gjitha këto mundësi, do ta bëjmë këtë nëse vlerësojmë se ZPS-ja nuk po e shfrytëzon siç duhet kohën që ka në depoziton”, ka thënë gjykatësi Smith.

Ai ka thënë se presin që ky gjyq të jetë i gjatë, derisa ka kërkuar nga prokuroria që të japë një parashikim të ditëve të gjyqit si dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tyre. “Ne presim

që ky gjyq të jetë i gjatë dhe ne vlerësojmë që periudha pesëvjeçare që parashikohet ka shqetësime të mëdha dhe po të isha unë një dëshmitar do të bëja vetë këto programe dhe të mos prisja për turpin gjykes, por mos keni gabime, ne do të kemi shkurtime nëse mendojmë që kjo është e domosdoshëm për ta mbrojtur të drejtën e të akuzuarve dhe për të bërë të mundur që këto procese penale të mos zgjaten tej mase. Ne do ta diskutojmë këtë me prokurorinë dhe do të kërkojmë të na jepet një parashikim i ditëve të gjyqit dhe të marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tyre”, ka thënë Smith.

ZPS-ja: Na duhen mbi 700 orë për ta paraqitur çështjen

Në konferencën përgatitore në çështjen ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ndaj të cilëve rëndojnë akuza me pretendime për krime lufte, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka deklaruar se do t’u duhen më shumë se 700 orë për ta paraqitur çështjen e tyre. “Prokuroria mbetet si edhe në listën e fundit,

Trumpi nis luftën personale me Jack Smith, përmend arrestimin e Thaçit

NUJ-YORK, 18 JANAR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka bërë një reagim ndaj ish-kryeprokurorit të Gjykatës Speciale, Jack Smith, pasi ky i fundit është angazhuar

nga ShBA-ja për hetimet që do të bëhen kundër vetë Trumpit. Trumpi e ka cilësuar Smithin si një person që e "urren Trumpin". Ndërkohë ka cituar edhe ish-emisarin Richard Grenell, për të

cilin ka thënë se i ka treguar se Smithi e ka burgosur një zyrtarë të lartë vetëm pse ka qenë një person me qasje pozitive ndaj Trumpit. Trumpi më shumë gjasë ka aluduar në ish-presidentin

Hashim Thaçi ndaj të cilit ishte ngritur aktakuzë nga Prokuroria e Gjykatës Speciale derisa ishte në aeroplan dhe po udhëtonte drejt Shtëpisë së Bardhë. "Si prokuror në Evropë, sipas Ric Grenell, ai burgosi një zyrtar të

lartë vetëm pse ishte një person me qasje pozitive ndaj Trumpit", ka shkruar Trumpi, duke thënë se Smith dhe njerëzit rreth tij njihen për "urrejtës të çmendur të Trumpit".



pak më shumë 700 orë", ka thënë prokurori Matthew Howling. Pas kësaj, gjykatësi Smith ka kërkuar nga prokuroria të tregojë sa a planifikon t'i thërrasë të gjithë 323 dëshmitarët që i kishte dorëzuar në listën paraprake. "Është një numër dëshmitarësh në këtë listë të cilët janë të rregullës 153 dhe 155, të cilët nuk synojmë t'i thërrasim të vijnë këtu, por do të mbështetemi në dëshminë e tyre. Jo të gjithë këta dëshmitarë do të vijnë këtu për të dhënë dëshminë para trupit gjykues dhe, në fakt, disa nuk e bëjnë dot një gjë të tillë, por ata që do të vijnë këtu për të dhënë dëshmi sipas rregullës 154 janë ata që janë në listë. Është e mundur që gjatë gjyqit dëshmitarët mund të paraqesin dëshmi që ta bëjnë të panevojshëm paraqitjen e dëshmitarëve të mëvonshëm, por

kjo do të varet nga zhvillimet gjatë gjyqimit", ka thënë prokurori.

Avokati i Veselit: Prokuroria ka dëshmitar që ka dëshmuar në katër gjyqe të mëparshme

Në këtë konferencë ka folur edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson. Ai ka thënë se ka dëshmitarë që kanë dhënë dëshmi në katër gjyqe të mëparshme. "Është një dëshmitar i cili ka dhënë dëshmi në katër gjyqe të mëparshme, ka bërë tetë intervista me ZPS-në, ka dhënë deklaratë në një numër procesesh të tjera penale ndërkombëtare, që të gjitha do të paraqiten këtu. Jam i sigurt që në këtë rastin e këtij dëshmitari, ZPS-ja do të kalojë një numër orësh duke theksuar ato elemente që dëshiron të thotë dhe

koha që do të na duhet ne për të bërë kundërpjetjet do të jetë shumë e gjerë pasi është një material i gjerë. Por në përgjithësi shkurtimi i afatit të kohës duke ulur pyetjet kryesore të prokurorisë së dëshmitarëve të cilët më pas vijnë me një dokumentacion të gjerë e ngre barrën që i bëhet palës mbrojtëse për këtë dhe ky është një nga problemet që ZPS-ja asnjëherë nuk është angazhuar", ka thënë Emmersoni, i cili është pajtuar që gjykimi të fillojë më 1 mars të këtij viti. "Parimisht nuk ka asnjë arsye pse të mos fillojmë më 1 mars, e vlerësojmë sigurisht dhe pajtohemi, besoj edhe kolegët e mi. Sigurisht ne kemi një periudhë të jashtëzakonshme intensive pune këtë muaj që, mbase, do të na krijojë disa vështirësi teknike në fakt, por ne në bashkëpunim me zyrën administrative kemi

pasur disa vështirësi për pikën e kontaktit në Kosovë. Psh., pra disa nga këto aspekte mund të na krijojnë disa pengesa, por unë nuk i parashikoj këto, por nuk shoh asnjë pengesë të fillojmë më 1 mars", ka thënë avokati i Kadri Veselit. Më tutje, Emmersoni ka thënë se janë dy procese gjyqësore ndërkombëtare që kanë konstatuar se UÇK-ja nuk kishte politikë të sulmit kundër civilëve. "Dy gjykime, ai i Haradinjat dhe Limajt, kanë konkluduar se nuk kishte politikë të UÇK-së të sulmonte civilët", ka thënë Emmersoni, teksa i është referuar diskutimit rreth pikës që ka të bëjë me akuzën për krime kundër njerëzimit. Ndërsa mbrojtja e Rexhep Selimit ka propozuar që të ketë pushime pas deklaratave hyrëse në mënyrë që mbrojtja të ketë mundësi të

përgatitet. Ata kanë kërkuar që në 12 dëshmitarët e parë të prokurorisë të mos ketë dëshmitarë që të flasin për pretendime konkrete ndaj Selimit meqë, sipas tij, kjo do të ndikonte në përgatitjen e mbrojtjes së tij. Një nga tjerat diskutime të rëndësishme që kanë diskutuar mbrojtja dhe prokuroria ishte edhe juridiksioni kohor i konfliktit të armatosur në Kosovë. Për këtë çështje, mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka theksuar se ka mospërputhje rreth periudhës së nisjes dhe mbarimit të konfliktit në mes të ZPS-së dhe vendimeve nga Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi, por edhe fakteve të tjera. Avokati i Hashim Thaçit, Luka Misteic, ka thënë se faktet që përdor Zyra e Prokurorit të Specializuar janë të njëjtat me ato që kishte përdorur edhe Tribunali për ish-Jugosllavi.

Reagim i KMDLNj-së

Oliver Ivanoviqi kishte përgjegjësi për ekzekutimin e 49 shqiptarëve gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë

Më 16 janar 2018, në ora 8:15 të mëngjesit para zyres së partisë që e drejtonte, në Mitrovicë ishte vrarë Oliver Ivanoviq, i akuzuar dhe i dënuar për krime lufte dhe shkelje të së drejtës humanitare me 9 vite burg ndërsa rasti ishte kthyer në shqyrtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Oliver Ivanoviq ishte një kohë deputet i Kuvendit të Kosovës sikur që portretizohej si lider i serbëve të veriut të Kosovës ndërsa për KMDLNj-në nuk kishte asnjë dyshim se ai kishte përgjegjësi komanduese dhe ishte urdhërdhënës për krime lufte dhe shkelje të zakoneve të luftës gjatë luftës së fundit në Kosovë sikur edhe për krime kundër njerëzimit, pas përfundimit të luftës. Në bazë të dëshmiave nga dëshmitarët që mbijetuan ekzekutimin dhe fakteve tjera të filmuara nga Halit Berani dhe bashkëpunëtorët në Qendrën Rajonale në Mitrovicë, Zyra e KMDLNj-së në Prishtinë e akuzoi Oliver Ivanoviqin për vrasjen e 39 shqiptarëve, që të gjithë civilë të paarmatosur gjatë luftës sikur edhe 9 shqiptarëve dhe 2 boshnjakëve, në shkurt të vitit 2000 në Mitrovicën e Veriut, e ndarë dhe e okupuar nga forcat paraushtarake dhe parapolicore serbe. Kallëzimet penale kundër Oliver Ivanoviqit dhe personave të tjerë nuk ishin trajtuar fillimisht nga UNMIK-u e pastaj as nga EULEX-i, deri në kohën kur këto dyshimje u bënë publike.

Pas denoncimeve të vazhdueshme për përgjegjësinë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj Oliver Ivanoviqit, më datë 23.04.2013, Halit Berani, koordinator i Q.R. të KMDLNj-së, Halit Berani ishte ftuar në EULEX, ku kishte dhënë deklaratë dhe ofruar prova me të cilën vërtetohet përgjegjësia e Oliver Ivanoviqit për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj civilëve shqiptarë, boshnjak dhe të tjerë. Pas kësaj Ivanoviq u arrestua dhe u dënua me 9 vite burg nga Gjykata Themelore kurse Gjykata e Apelit e kishte kthyer rastin në rishqyrtim. Po cilat ishin pretendimet e faktuara të KMDLNj-së kundër Oliver Ivanoviqit dhe të tjerëve për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit:

1. Më 14 .04. 1999, paramilitarë



dhe civilë serb të armatosur i kishin dëbuar me dhunë të gjithë banorët e Lagjes "Qendra 2", një pjesë të banorëve të Lagjes "Qendra 1" dhe të Lagjes "Ilirida". Në krye të këtyre forcave ishin Oliver Ivanoviq, i veshur në uniformën e policisë rezervë të Serbisë, Igor Simiq, Sergjan Aleksiç dhe të tjerë të cilët në lokacionin "Rruga e Kovaçevë" kishin grumbulluar 100 banorë shqiptarë, të rinjë dhe të gjinisë mashkullore, 31 prej të cilëve i ekzekutojnë ndërsa katër i lironjë me urdhër të Oliver Ivanoviqit. Këtë ekzekutim i ka paraprirë urdhëri i Ivanoviqit në pyetjen e një polici se ç'duhet të bëjmë me të ndaluarit, "postupaj po naredjenju - vepro sipas urdhërit ...". Pas ekzekutimit të 31 civilëve shqiptarë ishte planifikuar edhe ekzekutimi i të tjerëve por se në këtë kohë me një xhip kishte ardhë një oficer i ushtrisë së rregullt serbo - jugosllave që kishte ndërprerë këtë ekzekutim me fjalët: "keni bërë krim të luftës ..." për t'i dërguar të mbijetuarit me automjete të ushtrisë te stacioni i autobusve e që pastaj u deportuan dhunshëm për në Shqipëri. Të ekzekutuarit ishin varrosur në një lokacion djerrinë midis fshatrave Suhadoll dhe Vidmiriq. Nga 4 të liruuarit nga Oliver Ivanoviq vetëm njëri (Isa Mustafa) ka dhënë deklaratë të detajuar në KMDLNj që pastaj edhe ka dëshmuar në procesin gjyqësor kundër Ivanoviqit ndërsa 3 të tjerë nuk kanë dhënë deklaratë.

2. Më 16.04.1999 paramilitarë serb,

policë rezervistë dhe civilë serb të armatosur, nga një kolonë e civilëve shqiptarë që dhunshëm deportoheshin për në Shqipëri, në Lagjen "Ura e Gjakut", te Kroji i Broboniqit u ndanë 9 të rinjë shqiptarë që pastaj i futën në oborin e shtëpisë së Musa Likoshanit, ualidhën duart me tela rreth bunarit (pusit) dhe i ekzekutojnë që të gjithë. Këtë e bënë forcat serbe që udhëhiqeshin nga Oliver Ivanoviq, Dejan Saviq, Ratko Antonijević, Nenad Paviceviq dhe të tjerë.

3. Në mes të datave 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000 forcat e armatosura serbe, të pauniformuara dhe të papenguara nga xhandarmeria franceze, të udhëhequra nga Oliver Ivanoviq i quajtur Ola vranë 9 civilë shqiptarë dhe 2 boshnjakë në Lagjet "Lumbardhi" dhe "Kodra e Minatorëve" në pjesën e okupuar të Mitrovicës. Në të njëjtën kohë ishin dëbuar dhunshëm 1564 familje me 11,364 anëtarë, pjesa dërrmuese nuk është lejuar të kthehen në pronat e tyre. Kësaj maskre i ka paraprirë ketrajtimi brital i shqiptarëve nga "Rojat e Ures" që udhëhiqeshin nga Oliver Ivanoviq, si formacione paramilitare e që qendrën e kishin në kafeterinë "Dolce Vita". Janë me qindra informata dhe raporte të KMDLNj-së për këto ketrajttime. Në pikën 1. dhe 2., Oliver Ivanoviq dhe të tjerët kanë përgjegjësi konkrete dhe faktike për vepra penale të krimeve të luftës dhe shkeljes së ligjeve të luftës kurse në pikën 3. Oliver Ivanoviq dhe të tjerët kanë përgjegjësi për krime

kundër njerëzimit.

KMDLNj kishte kundërshtuar që një delegacion i Kuvendit të Kosovës të merrte pjesë në varrimin e Oliver Ivanoviqit sikur edhe aktivitetet tjera përcjellëse që e amnistionin dhe glorifikonin figurën e një të dyshuari dhe të dënuari për krime lufte e që ishte Oliver Ivanoviq. Çdo solidarizim me Oliver Ivanoviq dhe të tjerëve ishte dhe është fyerje për viktimat, familjet e tyre, Policinë e Kosovës për krime lufte, prokurorinë që bëri punë për qsa i lejonin mundësitë aq më parë që deri në vitin 2018 përgjegjësitë për krime lufte ishin te EULEX-i. Ky glorifikim është fyerje dhe shpërfille e punës së OJQ-ve që janë marrë me hulumtimin e rasteve të krimeve të luftës dhe, pa të cilët nuk do të mund të mbahej asnjë gjykim për krime lufte në Kosovë.

KMDLNj kundërshton fuqishëm adresimin e fundit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti me rastin e 5 vjetorit të vrasjes (të pasqaruar) të të dyshuarit dhe të dënuarit për krime lufte në Kosovë, Oliver Ivanoviq me fjalë që janë në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut, me të drejtat e viktimave për drejtësi dhe të drejtat e familjarëve për drejtësi dhe informata e që është dekurajim për të gjithë ata që angazhohen për drejtësi për viktimat dhe përgjegjësi për ata që kryen krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, pas një gjykimit të drejtë, të paanshëm

dhe të pandikueshën politikisht apo mbi ndonjë bazë tjetër. Duket qartazi se në Kosovë për shkak të një oportuniteti politik, krimet e luftës do të luftohen vetëm në planin retorik e që, me kalimin e kohës dhe ndonjë marrëveshje politike ato do të marginalizohen krejtësisht. Për KMDLNj-në është shqetësuese fakti se, as presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe as kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca nuk kanë reaguar për këtë adresim glorifikues të kryeministrit për Oliver Ivanoviq sikur edhe përpjekjet e disa deputetëve të krijojnë një diskurs arsyetues për këtë adresim i cili nuk ka asnjë bazë ligjore dhe as logjike. Duket pas këtij adresimi, të pakundërshtuar zyrtarisht të kryeministrit për rastin Ivanoviq, nuk ka mbetur asgjë tjetër përveç që kryetari i Kuvendit të Kosovës ta thërras një seancë të jashtëzakonshme ku presidentja do ta propozojë që Oliver Ivanoviq, post mortem të shpallet Qytetar Nderi, i Sinqertë dhe i Respektuar i Mitrovicës. Turp i përjetshëm dhe ekzekutim i sërishëm i viktimave të Oliver Ivanoviqit nga ata që me Kushtetutë duhet t'i përfaqësojnë dhe mbrojnë të gjitha viktimet, pavarësisht përkatësisë nacionale, fetare, moshës, gjinisë, bindjeve politike, statusit në shoqëri etj. KMDLNj ka ofruar fakte të mjaftueshme me të cilat vërtetohet përgjegjësia konkrete dhe faktike e Oliver Ivanoviqit dhe të tjerëve për veprat e krimeve të luftës, shkeljes së të drejtës humanitare dhe krimeve kundër njerëzimit përmes deklaratave të dëshmitarëve okularë, listave të personave të ekzekutuar, fotografi, filmime të rasteve, listave të personave të dëbuar dhunshëm, pengimi i personave të dëbuar dhunshëm që të kthehen në pronat e tyre si pasojë e spastrimit etnik. Vrasja e Oliver Ivanoviqit e pamundëson gjykimin e tij e që KMDLNj ka qenë jetësisht i interesuar dhe i angazhuar, për ta përcaktuar përgjegjësinë penale të tij por kjo, në asnjë mënyrë nuk nënkupton se veprat e tij kriminale të amnistohen, të relativizohen dhe që një kriminel lufte të glorifikohet.

Kuvendi miraton Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve

PRISHTINË, 18 JANAR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve që ishte propozuar nga ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari.

61 deputetë kanë marrë pjesë në votim, kur të gjithë kanë votuar pro këtij projektligji. Në të njëjtën kohë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë kërkuar dorëheqjen e ministres Rozeta Hajdari, pasi kjo e fundit është dënuar nga

gjykata për shkak të mosdeklarimit të pasurisë. Shefi i deputetëve të PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se deputetët e kësaj partie nuk do ta votojnë asnjë projektligji të propozuar nga ministrja Hajdari.





“I pikëlluar Albin Kurti”, PSD-ja para qeverisë vendos fotografinë e Ivanoviqit me kurora lulesh

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 18 janar - Partia Socialdemokrate (PSD), e cila drejtohet nga Dardan Molliqaj, ka mbajtur të mërkurën aksion simbolik para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Para objektit të qeverisë ata kanë vendosur fotografinë e ish-liderit serb, Oliver Ivanović dhe një kurorë lulesh ku shkruan “I pikëlluar Albin Kurti”.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se me këtë aksion e ngushëlluan kryeministrin Kurtin për Ivanovićin. “Bustin e Oliver Ivanovićit e vendosëm para Qeverisë së Kosovës. Funkcioni i bustit është i dyfishtë; ai ngushëllon Kurtin në njërën anë dhe shpërfaq tendencat e tij për

riinterpretim të figurës së Ivanovićit në anën tjetër. Ivanović është kriminel lufte i dënuar; Kurti po dëshiron ta riinterpretojë atë përbrenda

konfliktit të tij me Vuçiqin. Kështu e transformon në punëtorin e devotshëm të përkushtuar për një Kosovë multietnike. Qëllimi nuk arsyeton metodën. Ngjarjet e

individët, si në këtë rast Oliver Ivanović, nuk mund të jenë objekt riinterpretimi për teke të Kurtit. S’është thjesht hipokrizia, por rreziku i totalitarizmit që duhet të na shqetësojë. Përballë saj kërkojmë demokraci dhe përgjegjësi. Kryeministër, kërko falje!”, ka thënë Molliqaj. Kryeministri Albin Kurti para disa ditësh ka përkujtuar Oliver Ivanovićin në ditën e vdekjes, duke theksuar se Ivanović ishte një person i përkushtuar për të luftuar për interesat e komunitetit dhe qytetit të tij. “Ai e bëri këtë duke qenë i hapur, i sinqertë, gjithmonë i mprehtë në çështjet me rëndësi, por edhe i respektueshëm edhe ndaj atyre me të cilët nuk ishte dakord”, tha Kurti, duke theksuar tutje se do të dëshironte që kujtimi i tij të mbetet i gjallë. “Kujtimi i tij si një

njeri që punoi për një të ardhme të qëndrueshme dhe për një Kosovë shumë etnike”, kishte deklaruar Kurti për Ivanovićin në videon e ndarë në faqen e qeverisë në “Facebook”.

Përzgjedhja e fjalëve të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për politikanin serb, Oliver Ivanović në 5-vjetorin e vdekjes së tij, ka nxitur reagime të shumta në vend. Kurti është kritikuar pasi dikur ai dhe partia e tij e akuzonin Ivanovićin për krime lufte. Në janar të vitit 2016, lideri i Nismës Serbia, Drejtësia, Demokracia, Oliver Ivanović, i akuzuar për krime lufte në vitin 1999 si dhe vrasje të rëndë në vitin 2000, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me nëntë vjet burg. E këtë dënim Lëvizja Vetëvendosje, atë kohë në opozitë, e quante “poshtërim për drejtësinë”.



Bëhen homazhe te varrezat e heronjve Kadri Zeka dhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla

GJILAN, 18 JANAR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, me bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve me rastin e 41-vjetorit të rënies së heronjve të kombit, Kadri Zeka dhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla.

Kryetari Hyseni ka thënë se sakrificat e tyre për lirinë e vendit është motivi për angazhim dhe përkushtim në vazhdimin e rrugës të cilën na e trasuan me gjak. “Sakrificat e tyre për lirinë e vendit është motivi ynë për angazhim dhe përkushtim në vazhdimin e rrugës të cilën na e trasuan me gjak e mund. Qoftë i

përhershëm kujtimi për dëshmorët tanë! Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së martirëve të kombit!”, ka thënë Hyseni.

Po ashtu, është mbajtur edhe Akademia e “Flakës së Janarit 2023”, në të cilën është theksuar se muaji janar e bën Gjilanin kryeqendër kulturore të shqiptarëve.



Mafia energjetike dhe qeveria Kurti



Shkruan: Ferat SHALA

Me datën 18 nëntor 2021 në Kuvendin e Republikës së Kosovës publikisht kisha ngritur shqetësimet e mia dhe të Partisë Demokratike për mafinë energjetike. Për herë të parë atë ditë kam drejtuar gishtin nga mazhoranca. Sot po vërtetohen të gjitha ato që i kam thënë atëherë. Që nga ardhja e LV-së në pushtet vërehet tendenca bllokuese ndaj çdo projekti të investimit në energji të ripërtrishme. Edhe pse si shtet, jemi të ballafaquar me mungesë të kapaciteteve prodhuese dhe sistemit të vjetërsuar, kjo nuk e ka zmbarsur partinë në pushtet që të pengoj dhe bllokoj çdo lloj investimi në energji e sidomos në energji të pastër. Tanimë është e kuptueshme se nga ku e ka zanafillën ky obstrukcion i dirigjuar dhe i kontrolluar nga mafia e energjisë, e cila tek ne prek

edhe nivelet më të larta të pushtetit. Albin Kurti përmes Rozeta Hajdarit dhe Artane Rizvanollit, ka bllokuar të gjitha nismat dhe projektet investive që hyjnë në fushën e energjisë. Për të qenë më të qartë ju bëj me dije se vetëm përmes ligjit për investime strategjike, kanë qenë 6 (gjashtë) projekte të përgatitura nga investitorët privat për investim në energji të ripërtrishme, dhe atë në total investimi për këto projekte të ndryshme ishte paraparë të jetë 775.7 milionë euro dhe do të prodhoheshin 684.9 MW/h. Por jo, kjo qeveri zgjodhi rrugën e bllokimit të këtyre projekteve dhe krejt kjo bllokadë e dirigjuar nga qeveria Kurti dhe mafia energjetike e Ballkanit, e të cilat interesa më së miri i përfaqëson dhe i mbron sot kryeministri Albin Kurti.

Projektet të cilat janë bllokuar që dy vjet nga kjo qeveri janë:

ÇIÇAVICA WIND FARM 1 SHPK - Qëllimi i projektit investiv është krijimi i energjisë së gjelbër dhe të qëndrueshme. Projekti parashihte prodhimin e 90.1 MW/h, 17 Gjeneratorë me 5.3 MW Turbinë të ajrit, energji për 32,000 deri 47,000 amvisëri në vit. Investimi i

paraparë ishte 96 milion euro dhe prodhimi i 90.1 MW/h energji të ripërtrishme. **EUROKOS D.D SH.P.K** - me projektin "DRINI PSH 250 MW" - Ndërtimi i Hidrocentralit Reverzibil "DRINI PSHP" 250 MW është paraparë të realizohet për një periudhë katër vjeçare në Komunën e Prizrenit, fshati Vermicë, dhe përfshinë periudhën kohore 2022-2025, me një investim total prej 460 milion euro dhe prodhim të 250 MW/h energji të ripërtrishme. **ENERGY SUNDAY PARK** - Ky projekt kishte të paraparë investimin në vlerë 51.00 mil euro dhe kompania investuese Energy Sunday Park LLC kishte në pronësi hapësirën e cila do të mjaftonte për realizimin e këtij investimi. Projekti Energy Sunday Park parashihte një kapacitet të instaluar të paneleve solare prej 100 MW/h. **UNITAS ENERGY AG SHA** - Projekti i kompanisë kishte të bënte me instalimin e paneleve solare për prodhimin e 27.8 MW/h dhe investim prej 33.3 milionë euro. **NEXONE** - Projekti i kompanisë NEXONE parashihte investimin prej 62 milionë euro në parkun solar ku do të instaloheshin panelet solare për prodhimin e 50

MW/h energji të ripërtrishme. **BESIMI COMMERCE SH.P.K** - Projekti Besimi Solar synonte të ndërtojë një central elektrik fotovoltaik me kapacitet prej 147 MW/h dhe 20 MW, bateri që do të mund të shfrytëzohen për rregullimin e sistemit nga ana e operatorit të sistemit. Ky investim përveç se do të përmirësoj gjendjen energjetike në vend, ai do të mundësoj edhe punësimin e një numri të konsiderueshëm të punëtorëve të profileve të ndryshme. Nga ky projekt gjatë

fazës së ndërtimit pritej të punësoheshin rreth 900 punëtorë, kurse pas futjes në operim do të punësohen si punëtorë të rregullt afër 100 punëtorë të profileve të ndryshme. Investimi i paraparë nga kompania sipas raportit ishte 119.7 milionë euro dhe prodhim i 167 MW/h energji të ripërtrishme.

** Autori është kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi e Tregti dhe deputet i PDK-së*

Emri i Kompanisë	Vlera e Investimit	Lokacioni i Investimit	Erë Solare	Hidro	
UNITAS ENERGY AG.SHA	33,350,000.00 €	Ferizaj	27.8		
NEXONE LLC	62,000,000.00 €	Suharekë	50		
BESIMI COMMERCE SH.P.K	119,784,862.00 €	Shtime	167		
Cicavica Wind Farm 1 SHPK	100,620,000.00 €	Vushtrri	90.1		
Eurokos DD	460,000,000.00 €	Prizren		250	
Energy Sunday Park LLC	51,000,000.00 €	Klinë	100		
TOTAL MW	775,754,862.00 €	TOTAL MW/h	90.1	344.8	250
					684.9
					MW/h
					Total

Kosova forcon përpjekjet për kthimin e pasurive me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 18 janar - Qendra AIRE dhe Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, organizuan një aktivitet trajnimi në Prishtinë duke u përqendruar në kthimin dhe administrimin e pasurive, bizneseve, pasurive të paluajtshme komplekse, letrave me vlerë dhe instrumenteve financiare. Trajnimi u ofrua nga ekspertët ndërkombëtarë Jill Thomas dhe Thomas Abernathy, nga Asset Reality. Në hapje, zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka thënë se puna për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara njihet në nivel global si delikate dhe përbën një nga përgjegjësitë thelbësore të institucioneve të përfshira në këtë proces të rëndësishëm. "Ministria e Drejtësisë ka bërë ndryshime në Ligjin për Agjencinë e Administrimit të Pasurisë, ku deri tani nuk lejohej shitja, dhënia me qira apo shfrytëzimi i pronave të paluajtshme të sekuestruara, por tani, me

plotësimin/ndryshimin që ka filluar, një gjë e tillë do të jetë e mundur dhe shumë fitimprurëse", ka theksuar Sallahu. Koordinatorja Kombëtare e Qendrës AIRE, Ganimete Ismajli, ka deklaruar se kur e filluan projektin në vitin 2018, qëllimi kryesor ishte t'u përgjigjeshin drejtpërdrejt nevojave të institucioneve dhe t'i shfrytëzojnë kapacitetet në dispozicion në mënyrën më të dobishme. "Shpresoj shumë që trajnimi që po organizojmë në bashkëpunim me Asset Reality do të bëjë pikërisht këtë", ka deklaruar Ismajli. Aktiviteti i trajnimit kishte për qëllim t'u jepte pjesëmarrësve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'i administruar në mënyrë efektive pasuritë kriminale, e cila është një pjesë jetike e procesit të kthimit të pasurive. Trajnimi mbuloi aspektet teknike të administrimit të pasurive, duke përfshirë mënyrën e ruajtjes së vlerës së shtëpive, kompanive, veturave, stolive dhe sendeve të tjera luksoze të sekuestruara dhe të konfiskuara. Trajnimi theksoi gjithashtu rëndësinë e një qasjeje transnacionale dhe të



partneriteteve publike-private në administrimin e pasurive. Ekspertët dhe këshilltarët ndërkombëtarë Jill Thomas dhe TJ Abernathy nga Asset Reality u pajtuan me njëri-tjetrin duke thënë se të pasurit e një sistemi efektiv të administrimit të pasurive kriminale që ruan vlerën e shtëpive, kompanive, veturave, stolive dhe sendeve të tjera luksoze të cilat autoritetet kosovare i konfiskojnë nga kriminelët e dyshuar është një pjesë jetike e zinxhirit të kthimit të pasurive. "Kjo punë është shumë teknike në natyrë dhe kërkon rregullisht një qasje

transnacionale dhe partneritet publik-privat. Kosova i ka kushtuar rëndësi të madhe kthimit të pasurive, duke siguruar që vlera të ruhet për të mirën e shtetit, që çdo viktimitë që kërkon kompensim të marrë kompensim dhe që pasuritë t'u kthehen pronarëve nëse ato kthehen kur nuk vërtetohen rastet", theksuan ata. Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, ka theksuar rëndësinë e trajnimit, duke thënë se njohuritë dhe ekspertiza e ofruar nga ekspertët dhe këshilltarët ndërkombëtarë

do t'i ndihmojë shumë në përpjekjet e tyre për administrimin e pasurive kriminale dhe luftën kundër korrupsionit. "Konfiskimi i pasurive të paligjshme është një mesazh se pasuria kthehet aty ku e ka vendin", është shprehur ai. Ushtruesi i detyrës i drejtorit të AAPSK-së, Enver Krasniqi, gjithashtu ka theksuar rëndësinë e kthimit efektiv të pasurisë në luftën kundër krimit, duke thënë se kthimi i pasurisë është një aspekt kritik i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Riaktivizimi i konfliktit Kosovë-Serbi, plani i Rosisë për shpërqendrimin e SHBA-së nga Ukraina



Nga George FRIEDMAN

Ditët fundit ka pasur përplasje midis protestuesve etnikë serbë të armatosur dhe policisë së Kosovës. Arsyeja është se pak kohë më parë Kosova i ka urdhëruar shoferët në veri të venditë dorëzojnë targat e Serbisë dhe t'i zëvendësojnë me targat zyrtare të Kosovës.

Më 10 dhjetor, serbët që jetojnë në veri të Kosovës nisën të ngrenë barrikada. Banorët e Kosovës u përballën me ta, dhe policia e Kosovës bllokoi pikat kufitare. Pasi një bllokim trafiku si dhe një shkëmbim zjarri i shkurtër, që përfshiu edhe përdorimin e një granate trulllosëse.

Të shtënat janë ndërprerë, por janë shtuar kërcënimet. Një shkëmbim zjarri vetëm për disa targa mund të duket një reagim i tepëruar, por ky është Ballkani. Një zonë relativisht e vogël me shumë kombësi, dhe ku kufijtë politikë nuk përputhen me ato etnikë. Në vitet 1990, atje pati një luftë brutale civile midis këtyre grupeve etnike. Për shembull, serbët janë të krishterë, ndërsa boshnjakët janë myslimanë. Serbët dhe boshnjakët jetojnë në afërsi të njëri-tjetrit. Lufta civile që shpërtheu atje,

përfshiu edhe ngjirjen e kampeve të përqendrimit, dhe disa vlerësojnë se vdiqën mbi 100.000 boshnjakë, një shifër që hidhet poshtë nga serbët.

Megjithatë, askush nuk dyshon se ishte ajo luftë një kasaphanë. Luftimet rrezikonin të shtriheshin edhe në Kosovë, në jug të Serbisë. Kosovarët janë shqiptarë etnikë dhe në shumicë myslimanë që jetojnë në një zonë të pretenduar nga Serbia.

Kur forcat serbe nisën të hyjnë në Kosovë, qeveria amerikane dhe ato evropiane, të vetëdijshme për masakrën në Bosnje, ishin të shqetësuara se në Kosovë do të ndodhte një masakër tjetër. Avionët e NATO-s, kryesisht britanikë dhe amerikanë, ndërmoren sulme ajrore për t'i detyruar serbët të largoheshin.

Bombardimi u shtri në Serbi, dhe përfshiu sulme edhe kundër kryeqytetit serb, Beograd. Ato sulme shkaktuan shumë viktima në radhët e civilëve serbë. Shtetet e Bashkuara donin që të arrinin një armëpushim me serbët. Presidenti i Serbisë refuzoi, pjesërisht për shkak të zëvendësimit për bombardimin e Beogradit, dhe pjesërisht sepse kishte frikë se do të përballlej me akuzat në Hagë, gjë

që në fakt ndodhi.

Në pamundësi për të siguruar kapitullimin e Serbisë, sulmet ajrore vazhduan. SHBA-ja kontaktoi me rusët, të cilët kishin marrëdhënie të ngushta me serbët. Rusët i bindën këta tëfundit që pranonin një armëpushim. Në këmbim, rusët prisnin të trajtoheshin si pushtues të barabartë të Serbisë dhe Kosovës, duke imponuar armëpushimin në të gjitha rajonet si të barabartë me NATO-n.

Por amerikanët e mohuan se kishin rënë dakord për këtë me rusët. Rusët thonë se nuk kishin asnjë arsye për të negociuar me NATO-n përveç njohjes së statusit si një fuqi e madhe e barabartë. Trupat ruse mbërritën në aeroportin e Kosovës për të shërbyer si paqeruajtës.

Ata u rrethuan nga trupat e NATO-s dhe u detyruan të largoheshin. Ajo ngjarje pati një ndikim të madh në ngjirjen në pushtet të Vladimir Putinit dhe në mosbesimin e tij ndaj Shteteve të Bashkuara. Për më tepër ajo e bindi atë se SHBA-ja donte ta shkatërronte plotësisht Rusinë, dhe ai e mori presidencën me premtimin për të mos lejuar që Rusia të trajtohej me përbuzje në

të ardhmen.

Pra, kosovarët dhe serbët po zihen për targat. Dhe ajo që do të dukej si tepër e parëndësishme për të tjerët, nuk është e parëndësishme në këtë rajon. Në Ballkan, kujtimet janë të gjata dhe të pafalshme. Dhe ky rajon ndikon mbi gjithçka rreth tij. Lufta e Parë Botërore filloi pikërisht në Bosnje.

Por për kohën, përfundimi i luftës së Kosovës ngjalli një mosbesim të thellë të Rosisë ndaj Shteteve të Bashkuara. Aktualisht ka një luftë që përfshin Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara. Deri tani ajo nuk po shkon mirë për Moskën. Kur zhvillon një luftë, është jetike ta detyrosh armikun të zhvendosje gjetiu vëmendjen e tij, sidomos kur ka një ngërç në fushën e betejës.

Rusët kanë kërkuar mënyra të tjera për t'i shpërqendruar ukrainasit, por janë në fakt amerikanët ata që duhet të shpërqendrohen. Serbia është afër Rosisë, ashtu siç ka qenë për një kohë të gjatë. Shtetet e Bashkuara kanë një histori të gjatë të angazhimit në rajon.

Një konflikt tjetër ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, nuk do të ndryshonte vetvetiu rrjedhën e luftës në Ukrainë, por me shumë pak kosto ajo mund t'i detyrojë

amerikanët të humbasin njëfarë fokusi, nëse do të devijonin disa nga forcat për të mbrojtur Kosovën, një lloj detyrimi që i ka rrënjët që nga vitet 1990.

Në çdo rast, Rusia ka pak për të humbur, dhe Serbia është gjithmonë e gatshme të përplasat me Kosovën. Gjithçka nisi me përplasje të vogël për një çështje tepër në thelb të parëndësishme. Prandaj arsyeja e përplasjes me armë, nuk ka pasur lidhje me çështje të parëndësishme, por me përpjekjen për ta rindezur luftën e Kosovës.

Në rast se rusët donin një devijim me kosto dhe me rrezik të ulët, ata kishin shumë nxitje për të kontaktuar me Serbinë. Sigurisht që ka pasur përplasje edhe më parë. Por çështja nuk është se si nisin por çfarë mund të shkaktojnë ato. Prandaj duhet pasur shumë kujdes, se çfarëmund të prodhojnë ngjarjet e fundit në kufirin Serbi-Kosovë.

Shënim: George Friedman, është një parashikues gjeopolitik dhe strateg me famë për çështjet ndërkombëtare. Themelues dhe drejtues i think-tankut "Geopolitical Futures". / "Geopolitical Futures" – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Malisheva parqet Sokolin, Sermaxhaj për largim akuzon drejtorin Kastriot Kafegjollli

KF Malisheva ka qenë temë diskutimi në ditët e fundit pasi nuk vazhdoi bashkëpunimin me trajnerin Sami Sermaxhaj dhe të mërkurën e paraqiti Bylbyl Sokolin trajner të ri. Po të njëjtën ditë largimin nga ky klub e konfirmoi Sermaxhaj, i cili nuk la pa akuzuar drejtorin sportiv Kastriot Kafegjollli për sjellje jokorrekte ndaj tij dhe dy trajnerëve të tjerë, Petrit Rushiti dhe Qëndrim Kida

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

MALISHEVË, 18 JANAR - Trajneri i njohur në futbollin e Kosovës, Bylbyl Sokoli, është paraqitur te skuadra e Malishevës. Klubi që bën gara në Superligë e vlerëson lart trajnerin e ri, duke e quajtur ndër më të mirët në vend derisa pret edhe një sukses në elitë në krye me Sokolin. "Bylbyl Sokoli është padyshim një nga trajnerët më të mirë në Kosovë. Ka një përvojë impulsive. Ka menaxhuar top klubet kosovare si Prishtina, Gjilani e Llapi. Gjatë përvojës së tij si trajner ai u mësoi sportistëve disiplinë, punë të palodhshme dhe përkushtim dhe kjo

reflektohet jo vetëm në performancat e tyre në lojë e stërvitje, por edhe në qëndrimet e tyre në jetën e përditshme. Aftësitë e tij të shkëlqyeshme të organizimit dhe menaxhimit së bashku me pasionin e tij për përsosmëri janë motivuese. Arritja e marrëveshjes me trajnerin Sokoli është mjaft emocionuese për klubin tonë dhe presim që së bashku të jemi pjesë e suksesit të ardhshëm të klubit. Trajnerit i urojmë mirëseardhje në klub dhe presim me padurim të punojmë me të", thuhet në njoftimin e Malishevës. Të mërkurën largimin zyrtar e konfirmoi trajneri Sami Sermaxhaj me anë të një postimi



në "Facebook". Ai nuk la pa e akuzuar drejtorin sportiv të klubit, Kastriot Kafegjollin, për sjellje jokorrekte ndaj tij dhe dy trajnerëve të tjerë Petrit Rushiti dhe Qëndrim Kida. "Të dashur futbollistë të FC Malisheva, nga zemra ju uroj gjitha të mirat e

kësaj bote. Ishte kënaqësia ime dhe bashkëpunëtorëve të mi Petrit Rushiti dhe Qëndrim Kida të punonim me ju. Vlerësojeni vetë nëse ne ishim faktorë që nuk ju stërvitëm dhe udhëhoqëm profesionalisht apo ishte Kafexholli që qëllimisht na

mbante peng me kontrata të pavërtetuara në klub dhe federatë për të realizuar qëllimin e tij që veç u bë publik. Mirupafshim!", ka shkruar Sermaxhaj. Skuadra e Malishevës sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tetë me 19 pikë të grumbulluara.

Përfundon miniafati kalimtar në hendboll

PRISHTINË, 18 JANAR - Ka përfunduar miniafati kalimtar në hendbollin e Kosovës. Miniafati ishte i hapur prej 10 deri më 17 janar, ndërsa skuadra më e përforcuar pritet të dalë Trepça. Skuadra mitrovicase ka paraqitur kërkesë që nga Besa Famgas ta transferojë Deniz Terziqin. Prej Kastriotit, Trepça ka paraqitur kërkesë për transferimin e Lulëzim Shabanit e Shpëtim Mehmetit. Në drejtim të kundërt, nga Trepça te Kastrioti pritet të kalojë Arbër Aliu. Kastrioti ka paraqitur kërkesë edhe për Hamdi Salihun e Prishtinës. Kërkesë për dy përforcime ka bërë Rahoveci. "Vreshtarët" kanë paraqitur kërkesë për portierin e deritashëm të Besës, Arti Luzha, si dhe brazilianin e Deçanit,



Mateus Henrique. Skuadra pejane, Besa Famgas, ka paraqitur kërkesë për Nimon Idrizajn e Deçanit, ndërsa Samid Mekiçi pritet të bashkohet me

Prishtinën. Mekiçi në të kaluarën ka luajtur për Kastriotin, ndërsa te Prishtina pritet të vijë nga Suedia. Prishtina paraqiti kërkesë edhe për lojtarin nga Kuba,

Manuel Barrios Lores, që së fundi luajti në Portugali. Samadrexha ka paraqitur kërkesë për Besmir Mujën e Vushtrrisë. Me regjistrim të dyfishtë Samadrexhës pritet t'i bashkohen Arjanit Hyseni (Vushtrria) dhe Ermir Januzi (Trepça). Në konkurrencën e femrave, dy përforcime të mëdha i planifikon Ferizaj. KHF Ferizaj ka paraqitur kërkesë për Aida Stagovën dhe Shkurte Mehmetin që deri më tani ishin te Prishtina. Prej Ferizajt te Prishtina pritet të kalojë Mimoza Sefedini. Prej Prishtinës tek Ulpiana pritet të kalojë Donita Shala, kurse Iurosana Haskaj pritet të transferohet nga Deçani te Shqiponja. Të gjitha kërkesat e paraqitura në afatin kalimtar do të shqyrtohen nga komisioni për transferimin e lojtarëve.

KB Bashkimi ndan rrugët me Alihodziqin

PRIZREN, 18 JANAR - KB Bashkimi me marrëveshje të dyanshme ka ndarë rrugët me basketbollistin Fahro Alihodziq. Lajmin e ka bërë të ditur klubi prizrenas në faqen zyrtare. "Fahro Alihodziq më nuk do të jetë pjesë e klubit tonë. Me marrëveshje të dyanshme, e kemi shkëputur kontratën me Fahrton, i cili ka qenë pjesë e jona prej fillimit të sezonit. Klubi e falënderon Fahrton për angazhimin dhe i dëshiron suksese të mëtejme në karrierë. Faleminderit Fahro", thuhet në njoftimin e KB Bashkimi.



Kurti: Xhaka frymëzon shumë talente të rinj për të luajtur futboll

Cyrih, 18 janar - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një bisedë për gazetën zvicerane "Blick.ch", ka përmendur edhe futbollistët shqiptarë që luajnë në përfaqësuesen helveteke, Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri. "Zvicra është edhe shtëpia e disa futbollistëve të shkëlqyer me rrënjë kosovare", ka thënë fillimisht Kurti, ndërsa në

pyetjen e gazetarit se si e komenton gjestin e Xhakës që veshi fanellën me mbishkrimin Jashari, ai ka thënë se nëse dikush e nderon identitetin e tij, është e mirë dhe ai këtë ka bërë. "Mesazhi im për Xhakën, faleminderit që frymëzove kaq shumë talente të rinj për të luajtur futboll edhe në Kosovë!", ka shtuar Kurti.



Ymeri paraqitet te Trepça '89

Mitrovicë, 18 janar - Portieri Arion Ymeri ka kaluar nga Gjilani te Trepça '89 ku do ta vazhdojë karrierën. Gardiani drenicas që qëndroi vetëm

gjashtë muaj te Gjilani, edhe më tutje do të vazhdojë të jetë pjesë e elitës së futbollit. "Ymeri bëhet gardiani më i ri i Minatorëve. Arioni u

bashkohet gjelbërebardhëve duke përforcuar portën e skuadrës. Në të kaluarën ka mbrojtur portën e KF Drenicës dhe së fundmi të SC Gjilanit",

thuhet në njoftimin e klubit. Trepça '89 ka 19 pikë dhe mban vendin e nëntë në renditjen e Superligës së Kosovës.



Rijkaard: Messi e meritoi Kupën e Botës

Amsterdam, 18 janar - Ish-trajneri i Barcelonës, midis viteve 2003 dhe 2008, Frank Rijkaard ka dhënë një intervistë për "Helden Magazine". Tema kryesore e bisedës ishte ylli argjentinas Lionel Messi. Tekniku holandez foli për shpalljen e tij kampion bote, ritakimi me të në 2017-n etj. "Nuk më rrodhën lotët në faqe, pas finales së Kupës së Botës, por kam brohoritur shumë për atë që Messi kishte bërë këtë. Po e shikoja finalen mes Argjentinës dhe Francës, kryesisht si tifoz i Leos. Mendoj ai mori atë që donte, ai e meritonte", ka thënë Rijkaard.

Trajneri holandez tregoi se si ishte ribashkimi i tij i veçantë me argjentinasin në 2017-n. "Djali im Santi donte shumë të shihte një ndeshje të Barcelonës. Unë nuk isha tifoz i madh i stadiumeve në atë kohë. Biletat i mora përmes delegatit të ekipit, Karles Naval. Messi ishte super i



këndshëm dhe i afrueshëm. Ne u përqafuam dhe bëmë foto. Kjo, natyrisht, ishte veçanërisht argëtuese për djalin tim. Kur takova përsëri Leon pas një kohe

të gjatë, ai më bëri të ndiej diçka të veçantë. Ai ishte bërë ylli i madh, që e gjithë bota e futbollit po e shikon me gojë hapur", ka deklaruar Rijkaard.

Fitorja e shtatë radhazi për Denverin, clippersat mposhten nga Philadelphia

Denver, 18 janar - Fitorja e shtatë radhazi për Denverin, që mbron kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit. Ekipi i Nuggetsit mposhti me rezultat 122-113 Portlandin. Për miqtë, Lillard realizoi 44 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për Denverin shkëlqeu Nikola Jokiqi me një "triple double" (36 pikë, 12 rebounde e 10 asistime). Fitorja e dytë brenda 48 orësh në Los Anxhelos për ekipin e Philadelphias, që mposhti me rezultat 120-110 clippersat. Joel Embiid sërish protagonist, autor i 41 pikëve, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët



e Kawhi Leonardit për vendasit. Nuk zhgënjën në fushën e saj skuadra e Milwaukeees, që mundi me rezultat 130-122 Toronton, takim ku për vendasit u dallua Jrue Holiday me 37 pikë,

mbështetur nga Allen me 25 pikë. Befazon San Antonio, që mposhti me rezultat 106-98 Brooklynin, ndeshje ku Keldon Johnson realizoi 36 pikë, duke qenë lider për Spursin.

REZULTAT

Milwaukee - Toronto 130-122
San Antonio - Brooklyn 106-98
Denver - Portland 122-113
Clippers - Philadelphia 110-120

SHKURT

Nadali eliminohet nga 'Australian Open'

Rafael Nadal është mposhtur në "Australian Open" nga amerikanin McDonald me rezultatin 3-0 me sete, përkatësisht 6-4, 6-4 dhe 7-5. Udhëtimi i Rafa Nadalit ka përfunduar pasi humbi në tre sete ndaj McDonaldit dhe tashmë është jashtë "Grand Slam"-it të parë të vitit 2023. Tenisti spanjoll nuk është në ditët e tij më të mira dhe lëndimi gjatë setit të dytë, me amerikanin përpara me një set dhe një pushim, nuk e ndihmuan. Problemi në kofshë duket se ishte një goditje për Nadalin, pasi edhe pse mori një pushim mjekësor, ai nuk mundi të fitonte. Ky ishte eliminimi më i hershëm i spanjollit në "Australian Open" që nga viti 2016.

Botërori i Formulës 1, me 23 gara

Botërori 2023 në Formula 1 do të jetë me 23 gara. Drejtuesit e Formulës 1 kanë marrë vendimin për të mos zëvendësuar garën e Kinës me ndonjë garë tjetër, duke mbyllur përfundimisht mundësinë që të garohet në shtetin aziatik. Para disa ditësh u përfol se gara e Kinës mund të rikthehet në kalendar pas heqjes së masave anti-Covid. Formula 1 vendosi që të mos ndërhyjë në kalendarin e miratuar që më parë, duke konfirmuar një pushim të gjatë 4 javor, nga 2 deri më 30 prill (më 16 prill ishte planifikuar të organizohej gara në pistën e Shanghai). Ky është viti i katërt radhazi që anulohet gara e Kinës (hera e fundit, viti 2019, me fitues Lewis Hamiltonin). Botërori 2023 do të nisë më 5 mars në Bahrein dhe do të mbyllet më 26 nëntor në Abu Dhabi.

Tite largohet zyrtarisht nga Brazili

Adenor Leonardo Bacchi, i njohur më mirë si Tite, është larguar zyrtarisht nga kombëtarja e Brazilit. Trajneri, i cili ka drejtuar kombëtaren braziliane në gjashtë vjet e gjysmë dhe ka qenë në krye të Botërorit 2018 në Rusi dhe 2022 në Katar, ka ndërprerë kontratën me Federatën. "Dua t'i falënderoj lojtarët, punonjësit, drejtuesit dhe ju gazetarët me të cilët mund të kem pasur mendime të ndryshme, por gjithmonë me respekt absolut", ka thënë Tite. Brazili tashmë është në kërkim të një zëvendësuesi e primar mbetet emri i spanjollit Luis Enrique.

Wolverhamptoni zyrtarizon transferimin e Sarabias

Wolverhampton Wanderers me anë të një postimi në rrjetet sociale ka zyrtarizuar transferimin e Pablo Sarabias, i cili ka nënshkruar kontratë deri në qershor të 2025-ës. Sulmuesi spanjoll u bashkua me trajnerin Julen Lopetegui, pasi vendosi të largohet nga Paris Saint-Germain, për të nisur një përvojë të re me Wolvesin në Premierigë. 30-vjeçari ka qenë pjesë edhe e Sevillës dhe Getafës.

City kërkon Kvaratskhelian


Napoli në verën e ardhshme mund ta humbasë yllin e saj Khvicha Kvaratskhelia. Talenti gjeorgjian që po mahnit Italinë është në fokusin e kampionëve

në fuqi të Anglisë, Manchester City. "Qytetarët" janë bindur për 21-vjeçarin jo vetëm nga paraqitjet e tij në Serinë A, por më së shumti nga ndeshjet e

zhvilluara në Ligën e Kampionëve teksa ndihmoi të kaltrit për ta marrë vendin e parë në grup duke kontribuar me dy gola dhe tri asistime.

Napoli nuk do ta lëshonte kurrë pa përfituar të paktën 80 milionë euro, aq më tepër që lojtari është nën kontratë me italianët deri në vitin 2027. Nga

ana tjetër, gjeorgjiani ndihet i lumtur edhe për faktin që në Napoli futbollit përjetohet shumë pasi atij i pëlqen një ndjesi e tillë.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dr. Vjollca Hadri shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr. 534-0212/880003, datë:27.09.1988, KO-01174-01-15.

-Hysnije Kekeli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit "Prizren.

-Ishen Nasufaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.

-Flamur Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Luigj Gurakuqi" Nashec.

-Zenun Berisha nga Lipoveci KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Shaban Gola" Lipovec KK Gjakovë, nga kl IIX.

-Nazim Popaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

-Bislim Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III dhe diplomën e shme "Kadri Kusari" Bujqësi pemëtari vreshtari Gjakovë.

-Nebijete Dobruna nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shmm "Hysni Zajmi" teknik laborant i biologjisë.

-Egzon Daut Avdimetaj shpall të pavlefshme diplomën Kolegjit AAB-Prishtinë me nr. 2205/18.

- Taulant Leshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gëzim Haziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Duahi" Gjakovë.

- Yll Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Duahi" Gjakovë.

- Sevdije Shala nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. " Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë.

- Florian Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III, të SH.M.T. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Aber Bibiqaj nga Novosella KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gëzim Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues